



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.150/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevi dhe Faton Ademi anëtarë, me zyrtarin ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkritazi me ankesën e koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosje(LVV), dega në Gjilan, për shkak të vendosjes së postereve në objektin publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.150/2017 e datës 07.06.2017, nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datën 07.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, me seli Prishtinë, me të cilën pretendon se me datën 07.06.2017, kanë vërejtur se te komuna në qytetin e Gjilanit, se në objektin publik konkretisht në Administratën e Komunës ishin vendosur posteret e kandidatit të saj në kundërshtim me rregullat zgjedhore.Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e subjektit politik , është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b) e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, neni 3.4 të Rregullës Zgjedhore13/2014, sepse vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Në kërkesën për përgjigje në ankesë dërguar nga PZAP- për subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje, me datë 07.06.2017, nuk kanë jep ndonjë sqarim lidhur me ankesën ndërsa koalicioni PDK-AAK-NISMA, më datë 08.06.2017,ka paraqitur kërkesë për tërheqje të ankesës, në të cilën kanë deklaruar së tërhiqem nga të gjitha ankesat që nuk kanë vendim përfundimtar, të parashtruar kundër subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli nga fotografia e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posteret e kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, është i vendosur në objektin publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteret e kandidateve për deputet nga subjekti në fjalë, janë vendosur në objektin publike.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se shkelja e njëjtë nga subjekti politik LVV, është përsëritur disa herë në këtë proces zgjedhor, ku për kundër këtij fakti posterat e kandidatëve për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, janë vendosur në objektin publik.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, e datës 08.06.2017, për tërheqjen e ankesës Anr.150/2017 të datës 07.06.2017, e parashtruar ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paneli vlerëson se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.150/2017 më datën 09.06.2017.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.